



Duke u mbështetur në nenin 40.2 paragrafi 2 nën pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenit 40 paragrafi 2 pikën 5) të Statutit të Komunës së Klinës si dhe në Rregulloren për ndarjen e bursave për student - nr.01-06-8132/2020, përkatësisht nenin 3 të kësaj Rregulloreje, me kërkesën nr. 01-451-14642 të datës: 03.05.2023 e parashtruar nga drejtoria e arsimit Klinë, Rekomandimeve të KPF-së datë: 10.05.2023, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të rregullt për vitin 2023 të mbajtur me datën 26.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për ndarje të bursave për studentet e Komunës së Klinës për vitin akademik 2022-2023

1. Miratohet kërkesa e DKA-së për formimin e komisionit për ndarje të bursave për studentët e dalluar të Komunës së Klinës për vitin akademik 2022/2023.

1.1. Komisioni përbehet nga 5 anëtar:

1. Fatjona Gashi - Ekzekutivi
2. Elbarim Morina - Ekzekutivi
3. Arlinda Selitaj- KK “
4. Kushtrim Haliti - KK
5. Vlora Zhutaj - OJQ “ArtEko” Klinë

2. Komisioni punën e kryen në bazë të vendimit të miratuar nga kuvendi i komunës me datë: 26.05.2023, për ndarje të bursave për student dhe rregullores për ndarjen e bursave për studentët e Komunës.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

4. Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit, Zyra për Informim, dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-18047 /2023
Me datë 31.05 /2023



Kryesuesi i Seancës
Valmir Bacaj